

AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

" Qerreti" SH.P.K.

Sot, më date **26.09.2022**, une i nënshkruari:

- Esmeralda Hodaj, i dtl 06/08/1998, lindur ne Lushnje, banues ne Tirane, shtetas shqiptar, mbajtes i leternjofimit me nr.038411456, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar. ; në përputhje me Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008, "*Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare*" kemi vendosur të themelojme një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar të emëruar "**Qerreti**" SH.P.K. (më poshtë referuar si "Shoqëria"), duke nënshkruar këtë Akt Themelimi. Aktiviteti i kësaj Shoqërie do të rregullohet nga Statuti i saj, i cili është pjesë përbërëse e këtij Akti Themelimi dhe i bashkëngjitet si Shtojca 1.

Neni 1

Emri i Shoqërisë është: "**Qerreti**" SH.P.K.

Neni 2

(1)Selia e shoqërisë ndodhet në adresën: Qerret i Vjeter ,toke are me nr.pasurie 94/28, Komuna Fier Shegan ,Rrethi Lushnje ,Qarku Fier . Shoqeria ka te drejte te hape dege apo filiale ne te gjithë vendin.

(2)Adresa e shoqërisë për qëllime komunikimi elektronik është si vijon: esmeraldaqerreti @gmail.com Shoqeria ka te drejte te hape dege apo filiale ne te gjithë territorin e Republikës se Shqipërisë.

Neni 3

-Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë 10 vjet dhe fillon qe prej dates se regjistrimit te saj ne Regjistrin e Shoqerive Tregtare ne Qendren Kombetare te Regjistrimit.

Objekti i veprimtarise se shoqerise

Neni 4

Shoqëria do të kryej aktivitetin e mëposhtëm :

a.– Prodhim fruta perime ne serra diellore dhe ne fushe .

-Megjithate shoqeria ka te drejte qe te shtoje dhe te ndryshoje objektin e veprimtarise se saj me vendim te asamblese se ortakeve.

Neni 5

Kapitali themeltar

(1)Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është **100.000Lekë**. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

1. Ortaku themelues **Znj.Esmeralda Hodaj**: Zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme prej **100.000** leke ose përbën **100 %** të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Kontributi i ortakëve do të jetë në para .

Neni 6:

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Shtimi ose pakesimi i kapitalit themelor mund te behet vetem pasi Asamblea e ortakëve me shumice e ka dekretuar kete dhe per me teper te gjithe ortakët jane te detyruar qe ta repektojnë dhe te kontribuojne ne para ose ne natyre ne baze te vendimit te shumices se asmblese

Neni 7:

Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit te një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e te drejtat që rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo kalohen pëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërise
- b) shitblerjes;(me te drejten e parablerjes nga ana e ortakëve).
- c) trashëgimise;
- d) dhurimit;
- e) cdo menyre tjetër të parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë ligjerisht të trasferueshme ndërmjet ortakëve,përsa nuk parashikohet ndryshe në statur.

Pjesët e kapitakit themeltare janë ligjerisht të trasferueshme me rrugë trashgimnie.

Neni 8

Organi Vendimmarres

Asambleja e Ortakëve është organi i vetem vendimmarrës i shoqërisë.Asambleja e Ortakëve është organi i vetem vendimmarrës i shoqërisë që miraton cdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Mënyra e thirrjes së mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme, kuorumi, marrja e vendimeve ,përrjashtimi nga e drejta e votës dhe te tjera modalitete per funksionimin e organit vendimarrës përcaktohen ne statutin e shoqërise.

Neni 9

Administrimi

Administrator i shoqërisë emerohet :-**Esmeralda Hodaj**, lindur ne Lushnje dhe banues ne Tirane, shtetas shqiptar, mbajtes i letërnjoftimit me nr.038411456, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, i zgjedhur per nje periudhe 5 vjecare me te drejte rizgjedhje. Kompetencat dhe përgjegjesitë e Administratorit jane te percaktuara qarte ne statutin e shoqërisë.

Neni 10

Viti financiar-ekspertët

Viti financiar i shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përshtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e rregjistrimit në Qendrën Kombëtare të Rregjistrimit dhe mbyllet më 31 Dhjetor.

Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabel të veprimtarisë ekonomike tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e ortakëve.

Në përfundim të kontrollit eksperti kontabël i autorizuar pregatit raportin me shkrim për nxierien e rezulttit të bilancit financiar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që tja paraqesë e ta dorëzojë në kohë ortakëve për ti shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

Neni 11

Prishja-riorganizimi i shoqërisë

Modalitetet per prishjen dhe riorganizimin e shoqërisë jane te percaktuara ne statutin e shoqërisë në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

Neni 12

Akti i Themelimit eshte hartuar ne 4 kopje origjinale.

ORTAKU I VETEM

Esmeralda Hodaj

